



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.21/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e paraqitura nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN TË BAZUARA ankesat e OJQ-së Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.21/2026 dhe ZP.Anr.22/2026 të datës 04.06.2026, ashtu që subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 6,000 (gjashtëmijë euro) €.

II. DETYROHET Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën - I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

-Me datë 04.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër ZP.Anr.21/2026 të parashtruar nga OJQ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 3 qershor 2026, në sheshin qendror të komunës së Podujevës "Sheshi Zahir Pajaziti", subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje mbajti tubim publik me qytetarët e Podujevës në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026.

Gjatë këtij tubimi monitoruesit e KDI kanë vërejtur se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për kodin e mirësjelljes së subjekteve politike. Monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për

kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë.

Për më tepër, nga paraqitja e këtij tubimi publik edhe në media sociale dhe në portale informative të lajmeve, janë hasur që fëmijët në fjalë të cilët duket se përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare.

Sipas parashtresit të ankesës me këto veprime konsiderohet që është cenuar neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar ku në mënyrë shprehimore thuhet që: "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve."

Si provë kanë paraqitur linkun e videos ku shihen fëmijët në tubimin e subjektit LVV dhe fotografi.

<https://www.facebook.com/photo?fbid=1430163659149880&set=pcb1430182132481366>

-Po ashtu me datën 04.06.2026 PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.22/2026 nga organizata Instituti Demokratik i Kosovës- KDI, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 3 qershor 2026, në sheshin qendror të komunës së Lipjanit "Sheshi Adem Jashari", subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! mbajti tubim publik me qytetarët e Lipjanit në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. Gjatë këtij tubimi monitoruesit e KDI kanë vërejtur se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për kodin e mirësjelljes së subjekteve politike. Monitoruesit e KDI kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë. Për më tepër, nga paraqitja e këtij tubimi publik edhe në media sociale dhe në portale informative të lajmeve, janë hasur që fëmijët në fjalë të cilët duket se përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare.

Prandaj, bazuar në këto veprime konsiderojmë që është cenuar neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar ku në mënyrë shprehimore thuhet që: "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.*" Andaj, konsiderojmë që nga video e shfaqur janë konsumuar të gjitha elementet e cenimit të nenit 5 par.3 të rregullores 07/2024 dhe veprimi tillë kundërligjor nuk do duhej të tolerohej.

Si provë ka bashkangjitur: linku i videos ku shihen fëmijët në tubimin e subjektit LVV:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=14301468591515601430160255816887>

-Në përgjigje në ankesë ZP.Anr.21/2026 e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) theksohet se në ankesën e KDI-së, pretendohet se gjatë tubimit publik të mbajtur më 3 qershor 2026 në Podujevë, janë përfshirë fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Mirëpo, nga përshkrimi i vetë ankesës dhe

nga provat e bashkëngjitura, nuk rezulton asnjë fakt që dëshmon se ndonjë fëmijë është angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje në fushatë zgjedhore.

Dispozita e nenit 5 paragrafi 3 ndalon angazhimin e personave nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore, ndërsa parashikon se pjesëmarrja e fëmijëve nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë që fëmijët e paraqitur në video kanë qenë të angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje, se kanë kryer ndonjë aktivitet fushate, se kanë shpërndarë materiale propaganduese, kanë mbajtur fjalime, kanë bërë thirrje për votim apo kanë ushtruar çfarëdo roli aktiv në funksion të fushatës zgjedhore.

Më tej në përgjigje theksohet se prania e fëmijëve në një tubim publik politik, në shoqërinë e familjarëve të tyre apo pjesëmarrësve të tjerë, nuk mund të barazohet automatikisht me "angazhim në fushatë zgjedhore". Interpretimi i propozuar nga ankuesi do të nënkuptonte se çdo prezencë e një të mituri në një aktivitet publik politik përbën shkelje, gjë që nuk rrjedh nga përmbajtja e dispozitës përkatëse dhe nuk përkrahet nga qëllimi i saj normativ.

Sipas përgjigjes në ankesë, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me moshën e personave të paraqitur në video, as nuk ka paraqitur ndonjë provë që ata kanë qenë të pranishëm pa prezencën ose pëlqimin e prindërve të tyre. Pretendimet e tilla mbeten tërësisht hipotetike dhe të pambështetura në prova. E barra e provës për ekzistimin e shkeljes bie mbi ankuesin.

Në rastin konkret nuk është dëshmuar as elementi material i shkeljes së pretenduar, përkatësisht veprimi i angazhimit të miturve nga subjekti politik, e as rrethanat tjera të kërkuara nga dispozita e nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024.

Duke qenë se ankesa nuk mbështetet në prova që do të dëshmonin kryerjen e shkeljes së pretenduar, propozojnë që PZAP ta refuzojë ankesën si të pabazuar.

-Në përgjigjen në ankesë ZP.Anr.22/2026 të datës 05.06.2026, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i kundërshton pretendimet e ankesës së parashtruar nga organizata KDI, se gjatë tubimit publik të mbajtur më 3 qershor 2026 në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan janë parë fëmijë të cilët duket se i përkasin moshës nën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare dhe, mbi këtë bazë, pretendon se është shkelur neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Megjithatë, nga vetë përmbajtja e ankesës dhe provat e bashkëngjitura nuk rezulton asnjë fakt apo dëshmi që do të vërtetonte se ndonjë fëmijë është angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje në fushatë zgjedhore. Ndërsa, vetë ankesa është e paqartë dhe e pasaktë në përshkrimin e shkeljes së pretenduar. Në paragrafin e dytë, ankuesi thekson se *"Monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë"*. Kjo fjali është e papërfunduar dhe nuk përmban asnjë pretendim konkret faktik. Nga ajo nuk kuptohet se cili veprim pretendohet se është kryer, nga kush është kryer dhe si lidhet ai me dispozitën e pretenduar si të shkelur.

Për këtë arsye, ankesa nuk e përmbush standardin minimal të qartësisë për përshkrimin e shkeljes së supozuar. Dispozita në të cilën mbështetet ankuesi përcakton se *"Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore"*. Nga përmbajtja e kësaj norme rezulton qartë se elementi thelbësor i shkeljes është angazhimi i personave

nën moshën 15-vjeçare në aktivitete të fushatës zgjedhore. Vetë prania e fëmijëve në një tubim publik nuk përbën angazhim dhe nuk mund të konsiderohet shkelje e kësaj dispozite. Ankuesi nuk pretendon dhe nuk provon se ndonjë fëmijë ka marrë pjesë aktive në organizimin e tubimit, ka shpërndarë materiale propaganduese, ka kryer aktivitete në emër të subjektit politik, ka mbajtur fjalim apo është angazhuar në çfarëdo forme nga Lëvizja Vetëvendosje. Pretendimi i vetëm është se në tubim kanë qenë të pranishëm disa fëmijë. Një interpretim i tillë do të nënkuptonte se çdo tubim politik ku marrin pjesë familje me fëmijët e tyre do të përbënte automatikisht shkelje zgjedhore, gjë që është qartazi në kundërshtim me qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitës së lartcekur. Për më tepër, ankuesi nuk ka identifikuar asnjë person konkret për të cilin pretendon se është nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare.

Ankesa nuk përmban asnjë dëshmi lidhur me moshën e personave që shfaqen në materialin e referuar dhe nuk paraqet asnjë provë objektive që do të mundësonte konstatimin e moshës së tyre. Pretendimi mbështetet vetëm në vlerësimin subjektiv të ankuesit se personat në fjalë *“duket se i përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare”*, gjë që nuk mund të konsiderohet provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistimin e një shkeljeje zgjedhore. Po ashtu, ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë se personat në fjalë kanë qenë të pranishëm pa praninë apo pëlqimin e prindërve të tyre. Përkundrazi, vetë dispozita e nenit 5 paragrafi 3 e Rregullores Nr.07/2024 parasheh mundësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitet të fushatës, duke e ndërlidhur atë me prezencën apo pëlqimin e prindërve. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt apo dëshmi që do të mund të vinte në dyshim ekzistimin e këtyre rrethanave. Për të gjitha arsyet e lartcekura, rezulton se provat e bashkëngjitura në ankesë dëshmojnë vetëm praninë e disa personave të mitur në një tubim publik dhe në asnjë mënyrë nuk dëshmojnë angazhimin e tyre nga Lëvizja Vetëvendosje në kuptim të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.21/2026 dhe ZP.Anr.22/2026, të paraqitura me datë 04.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZP.Anr.21/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kundër subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore nga ankesat si dhe përgjigjet në ankesë, gjeti se:

- Ankesat janë të bazuara.

Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave vëren se nga fotografitë, dhe linqet e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesave, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, është konstatuar se në tubimet e mbajtura më 3 qershor 2026, në sheshin qendror të Komunës së Podujevës, "Sheshi Zahir Pajaziti", dhe sheshin "Adem Jashari" në Lipjan, kanë marrë pjesë fëmijë të mitur, veprime këto që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën

është përcaktuar se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore.”*

Paneli vlerëson se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore. *Bazuar në instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përcaktojnë kufij të qartë se çdo veprim duhet të jetë në interes të mirë të fëmijëve dhe të mos përdoren fëmijët për propagandë partiake, që të mos përfshihen fëmijët në përhapjen e mesazheve politike apo partiake që ata nuk mund ti kuptojnë përmbajtjen e tyre, që fëmijët mos të përdoren si imazhe për përfitim elektoral.*

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe pretendimet në përgjigje në ankesa të subjektit politik LVV se *“Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë që fëmijët e paraqitur në video kanë qenë të angazhuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, se kanë kryer ndonjë aktivitet fushate, se kanë shpërndarë materiale propaganduese, kanë mbajtur fjalime, kanë bërë thirrje për votim apo kanë ushtruar çfarëdo roli aktiv në funksion të fushatës zgjedhore...”*, dhe të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pabazuara, për faktin se në momentin kur organizatori i aktivitetit i ka mundësuar të miturve pjesëmarrjen në tubim elektoral, pjesëmarrja e tyre konsiderohet përfshirje aktive në fushatë zgjedhore. Sepse për zbatimin e kësaj norme nuk është vendimtare nëse iniciativa për paraqitjen e të miturve ka ardhur nga organizatori apo nga vetë i mituri, por vet fakti se subjekti politik ka lejuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive, në një aktivitet zyrtar zgjedhor ai konsiderohet përgjegjës përkatësisht Subjekti Politik LVV

Lidhur me pretendimet nga përgjigjet në ankesë se *“prania e fëmijëve në një tubim publik politik, në shoqërinë e familjarëve të tyre apo pjesëmarrësve të tjerë, nuk mund të konsiderohet si pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore”*. Paneli vlerëson se është i parëndësishëm fakti se familjarët e tyre nuk e kanë kundërshtuar pjesëmarrjen e tyre në tubim, por i rëndësishëm është fakti se të miturit në asnjë rrethanë nuk kanë mundur të gjendet në atë aktivitet politik, ngase ky veprim si u tha më lartë bije në kundërshtim me rregullat zgjedhore.

Në këtë kuptim, për Panelin këto veprime janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit më gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: se përfshirja e fëmijëve në fushatë zgjedhore përbenë shkelje të të drejtave të tyre, dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike ti angazhojnë në fushatë zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës si dhe është dënuar edhe më herët për përfshirjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore

Mbi këtë bazë, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e KDI-së si

palë ankuese janë të bazuara, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesa paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, të rregullës zgjedhore.


Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.21/2026, datë 06.06.2026



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.25/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Faton Bajrami dhe Delushe Halimi anëtarë, lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shqiptimit të gjobës së subjektit politik LVV, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.21/2026, të datës 06.06.2026, në seancën e mbajtur me datë 11.06.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), ZP.Anr.21/2026, të datës 06.06.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.21/2026, të datës 06.06.2026, është vendosur: "I. PRANOHEN TE BAZUARA ankesat e OJQ-së Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.21/2026 dhe ZP.Anr.22/2026 të datës 04.06.2026, ashtu që subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6,000 (gjashtëmijë euro) €. II. DETYROHET Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi".

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën pretendon se PZAP ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 paragraf 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, kur ka konstatuar se pjesëmarrja e fëmijëve në tubim zgjedhor përbënë përfshirje aktive në fushatë zgjedhore, kjo pasi që rregullorja në fjalë nuk sanksionon çdo prani, paraqitje apo pjesëmarrje të të miturve në aktivitet politik, por sanksionon angazhimin e tyre nga subjekti politik, andaj i ka propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të anuloj vendimin e PZAP, ZP.Anr.21/2026.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi theksin



ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.21/2026, i datës 06.06.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 04.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër ZP.Anr.21/2026 të parashtruar nga OJQ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 3 qershor 2026, në sheshin qendror të Komunës së Podujevës "Sheshi Zahir Pajaziti", subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje mbajti tubim publik me qytetarët e Podujevës në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. Gjatë këtij tubimi monitoruesit e KDI kanë vërejtur se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për kodin e mirësjelljes së subjekteve politike. Monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë. Për më tepër, nga paraqitja e këtij tubimi publik edhe në media sociale dhe në portale informative të lajmeve, janë hasur fëmijët në fjalë të cilët duket se i përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare.

Më tej është theksuar se sipas parashtruesit të ankesës me këto veprime konsiderohet që është cenuar neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar ku në mënyrë shprehimore thuhet që: "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve". Si provë kanë paraqitur linkun e videos ku shihen fëmijët në tubimin e subjektit LVV dhe fotografi. <https://www.facebook.com/photo?fbid=1430163659149880&set=pcb1430182132481366>

Po ashtu me datë 04.06.2026 PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.22/2026 nga organizata Instituti Demokratik i Kosovës- KDI, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 3 qershor 2026, në sheshin qendror të Komunës së Lipjanit "Sheshi Adem Jashari", subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! mbajti tubim publik me qytetarët e Lipjanit në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. Gjatë këtij tubimi monitoruesit e KDI kanë vërejtur se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dispozitat e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për kodin e mirësjelljes së subjekteve politike. Monitoruesit e KDI kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë. Për më tepër, nga paraqitja e këtij tubimi publik edhe në media sociale dhe në portale informative të lajmeve, janë hasur fëmijët në fjalë të cilët duket se i përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare.



Prandaj, bazuar në këto veprime kanë konsideruar që është cenuar neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 Për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar ku në mënyrë shprehimore thuhet që: “Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”. Andaj, kanë konsideruar se që nga video e shfaqur janë konsumuar të gjitha elementet e cenimit të nenit 5 par.3 të rregullores 07/2024 dhe veprimi tillë kundërligjor nuk do duhej të tolerohej. Si provë ka bashkëngjitur: linku i videos ku shihen fëmijët në tubimin e subjektit LVV-së.

Në përgjigjen në ankesë ZP.Anr.21/2026 e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se në ankesën e KDI-së, pretendohet se gjatë tubimit publik të mbajtur më 3 qershor 2026 në Podujevë, janë përfshirë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Mirëpo, nga përshkrimi i vetë ankesës dhe nga provat e bashkëngjitura, nuk rezulton asnjë fakt që dëshmon se ndonjë fëmijë është angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje në fushatë zgjedhore. Dispozita e nenit 5 paragrafi 3 ndalon angazhimin e personave nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore, ndërsa parashikon se pjesëmarrja e fëmijëve nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë që fëmijët e paraqitur në video kanë qenë të angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje, se kanë kryer ndonjë aktivitet fushate, se kanë shpërndarë materiale propaganduese, kanë mbajtur fjalime, kanë bërë thirrje për votim apo kanë ushtruar çfarëdo roli aktiv në funksion të fushatës zgjedhore.

Më tej në përgjigje theksohet se prania e fëmijëve në një tubim publik politik, në shoqërinë e familjarëve të tyre apo pjesëmarrësve të tjerë, nuk mund të barazohet automatikisht me "angazhim në fushatë zgjedhore". Interpretimi i propozuar nga ankuesi do të nënkuptonte se çdo prezencë e një të mituri në një aktivitet publik politik përbën shkelje, gjë që nuk rrjedh nga përmbajtja e dispozitës përkatëse dhe nuk përkrahet nga qëllimi i saj normativ. Pastaj kanë theksuar se sipas përgjigjes në ankesë, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me moshën e personave të paraqitur në video, as nuk ka paraqitur ndonjë provë që ata kanë qenë të pranishëm pa prezencën ose pëlqimin e prindërve të tyre. Pretendimet e tilla mbeten tërësisht hipotetike dhe të pambështetura në prova. E barra e provës për ekzistimin e shkeljes bie mbi ankuesin. Në rastin konkret nuk është dëshmuar as elementi material i shkeljes së pretenduar, përkatësisht veprimi i angazhimit të miturve nga subjekti politik, e as rrethanat tjera të kërkuara nga dispozita e nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Si rrjedhojë duke qenë se ankesa nuk mbështetet në prova që do të dëshmonin kryerjen e shkeljes së pretenduar, kanë propozuar që PZAP ta refuzojë ankesën si të pabazuar.

Në përgjigjen në ankesë ZP.Anr.22/2026 të datës 05 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i ka kundërshtuar pretendimet e ankesës së parashtruar nga organizata KDI, se gjatë tubimit publik të mbajtur më 3 qershor 2026 në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan janë parë fëmijë të cilët duket se i përkasin moshës nën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare dhe, mbi këtë bazë, pretendon se është shkelur neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Megjithatë, nga vetë përmbajtja e ankesës dhe provat e bashkëngjitura nuk rezulton asnjë fakt apo dëshmi që do të vërtetonte se ndonjë fëmijë është angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje në



fushatë zgjedhor, ndërsa, vetë ankesa është e paqartë dhe e pasaktë në përshkrimin e shkeljes së pretenduar. Në paragrafin e dytë, ankuesi thekson se *"Monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se gjatë këtij tubimi në kohën kur kandidati për Kryeministër Albin Kurti filloi prezantimin e platformës së tij programore dhe kandidatëve për deputetë"*. Kjo fjali është e papërfunduar dhe nuk përmban asnjë pretendim konkret faktik. Nga ajo nuk kuptohet se cili veprim pretendohet se është kryer, nga kush është kryer dhe si lidhet ai me dispozitën e pretenduar si të shkelur.

Për këtë arsye, ankesa nuk e përmbush standardin minimal të qartësisë për përshkrimin e shkeljes së supozuar. Dispozita në të cilën mbështetet ankuesi përcakton se "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore". Nga përmbajtja e kësaj norme rezulton qartë se elementi thelbësor i shkeljes është angazhimi i personave nën moshën 15 vjeçare në aktivitete të fushatës zgjedhore. Vetë prania e fëmijëve në një tubim publik nuk përbën angazhim dhe nuk mund të konsiderohet shkelje e kësaj dispozite. Ankuesi nuk pretendon dhe nuk provon se ndonjë fëmijë ka marrë pjesë aktive në organizimin e tubimit, ka shpërndarë materiale propaganduese, ka kryer aktivitete në emër të subjektit politik, ka mbajtur fjalim apo është angazhuar në çfarëdo forme nga Lëvizja Vetëvendosje. Pretendimi i vetëm është se në tubim kanë qenë të pranishëm disa fëmijë. Një interpretim i tillë do të nënkuptonte se çdo tubim politik ku marrin pjesë familje me fëmijët e tyre do të përbënte automatikisht shkelje zgjedhore, gjë që është qartazi në kundërshtim me qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitës së lartcekur. Për më tepër, ankuesi nuk ka identifikuar asnjë person konkret për të cilin pretendon se është nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare.

Më tej është theksuar se ankesa nuk përmban asnjë dëshmi lidhur me moshën e personave që shfaqen në materialin e referuar dhe nuk paraqet asnjë provë objektive që do të mundësonte konstatimin e moshës tyre. Pretendimi mbështetet vetëm në vlerësimin subjektiv të ankuesit se personat në fjalë "duket se i përkasin moshës më të vogël se 15 vjeçare", gjë nuk mund të konsiderohet provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistimin e një shkeljeje zgjedhore. Po ashtu, ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë se personat në fjalë kanë qenë të pranishëm pa praninë apo pëlqimin e prindërve të tyre. Përkundrazi, vetë dispozita e nenit 5 paragrafi 3 e Rregullores Nr.07/2024 parasheh mundësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete të fushatës, duke e ndërlidhur atë me prezencën apo pëlqimin e prindërve. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt apo dëshmi do të mund të vinte në dyshim ekzistimin e këtyre rrethanave. Për të gjitha arsyet e lartcekura, rezulton se provat e bashkëngjitura në ankesë dëshmojnë vetëm praninë e disa personave të mitur në një tubim publik dhe në asnjë mënyrë nuk dëshmojnë angazhimin e tyre nga Lëvizja Vetëvendosje në kuptim të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia PZAP, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.21/2026 dhe ZP.Anr.22/2026, të paraqitura më datë 04.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZP.Anr.21/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Organizata



Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore nga ankesat si dhe përgjigjet në ankesë, gjeti se ankesat janë të bazuara. Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave vëren se nga fotografitë, dhe linqet e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesave, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, është konstatuar se në tubimet e mbajtura më 3 qershor 2026, në sheshin qendror të Komunës së Podujevës, "Sheshi Zahir Pajaziti", dhe sheshin "Adem Jashari" në Lipjan, kanë marrë pjesë fëmijë të mitur, veprime këto që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën është përcaktuar se "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore". Paneli ka vlerësuar se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore. Bazuar në instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e te drejtave të fëmijëve përcaktojnë kufij të qartë se çdo veprim duhet të jetë në interes më të mirë të fëmijëve dhe të mos përdoren fëmijët për propagandë partiake, që të mos përfshihen fëmijët në përhapjen e mesazheve politike apo partiake që ata nuk mund ti kuptojnë përmbajtjen e tyre, që fëmijët të mos përdoren si imazhe për përfitim elektoral.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe pretendimet në përgjigje në ankesa të subjektit politik LVV se *"Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë që fëmijët e paraqitur në video kanë qenë të angazhuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, se kanë kryer ndonjë aktivitet fushate, se kanë shpërndarë materiale propaganduese, kanë mbajtur fjalime, kanë bërë thirrje për votim apo kanë ushtruar çfarëdo roli aktiv në funksion të fushatës zgjedhore..."* dhe të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pabazuara, për faktin se në momentin kur organizatori i aktivitetit i ka mundësuar të miturve pjesëmarrjen në tubim elektoral, pjesëmarrja e tyre konsiderohet përfshirje aktive në fushatë zgjedhore. Sepse për zbatimin e kësaj norme nuk është vendimtare nëse iniciativa për paraqitjen e të miturve ka ardhur nga organizatori apo nga vetë i mituri, por vet fakti se subjekti politik ka lejuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive, në një aktivitet zyrtar zgjedhor ai konsiderohet përgjegjës përkatësisht Subjekti Politik LVV.

Lidhur me pretendimet nga përgjigjet në ankesë se *"prania e fëmijëve në një tubim publik politik, në shoqërinë e familjarëve të tyre apo pjesëmarrësve të tjerë, nuk mund të konsiderohet si pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore"*. Paneli ka vlerësuar se është i parëndësishëm fakti se familjaret e tyre nuk e kanë kundërshtuar pjesëmarrjen e tyre në tubim, por i rëndësishëm është fakti se të miturit në asnjë rrethanë nuk kanë mundur të gjenden në atë aktivitet politik, ngase ky veprim si u tha më lartë bije në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Në këtë kuptim, për Panelin këto veprime janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli në fund ka shtuar se me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit në gjyq si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: se përfshirja e



fëmijëve në fushata zgjedhore përbënë shkelje të të drejtave të tyre, dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike ti angazhojnë në fushata zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës si dhe është dënua edhe më herët për përfshirjen e fëmijëve në fushata zgjedhore. Mbi këtë bazë, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e KDI-së si palë ankuese janë të bazuara, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesa paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, të rregullës zgjedhore.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me aprovimin e ankesave të OJQ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe shqiptimin e gjobës subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, respektivisht pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë se PZAP ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 paragraf 3 të Rregullores Nr. 07/2024, me pretendimet se rregulloja e lartcekur nuk sanksionon ç'është prani, paraqitje apo pjesëmarrje të të miturve në një aktivitet publik politik, por sanksionon angazhimin e tyre nga subjekti politik, nga kolegji i Gjykatës Supreme, vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të zbatimit të gabuar të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, respektivisht nenin 5 paragraf 3 të të njëjtës rregulloreje, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e aprovimit të ankesave të OJQ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se ky subjekt politik ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, si rrjedhojë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 6000 €. Në lidhje me këtë, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, PZAP ka bashkuar ankesat ZP.Anr.21/2026 dhe ZP.Anr.22/2026, të paraqitura më datë 04.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, nën shenjë e përbashkët ZP.Anr.21/2026, për shkak të natyrës së njëjtë



të çështjeve të parashtruara nga OJQ (KDI), kundër subjektit politik (LVV), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Nga shkresat e lëndës rezulton se nga fotografitë, dhe linqet e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesave, OJQ IKD, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, ka rezultuar se në tubimet e mbajtura më 3 qershor 2026, në sheshin qendror të Komunës së Podujevës, “Sheshi Zahir Pajaziti”, dhe sheshin “Adem Jashari” në Lipjan, kanë marrë pjesë fëmijë të mitur, veprime këto që janë konsideruar në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, ku me paragraf 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”*. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për zbatim të gabuar të dispozitës nga neni 5 paragraf 3 të Rregullores së lartcekur, gjatë shqyrtimit të ankesës Gjykata Supreme të njëjtat pretendime i ka vlerësuar si të pabazuara, kjo pasi që Paneli me të drejtë ka vlerësuar se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, si rrjedhojë është vlerësuar se të njëjtit në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore. Për më tepër edhe instrumentet ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përcaktojnë kufij të qartë se çdo veprim duhet të jetë në interes më të mirë të fëmijëve dhe të mos përdoren fëmijët për propagandë partiake, që të mos përfshihen fëmijët në përhapjen e mesazheve politike apo partiake që ata nuk mund ti kuptojnë përmbajtjen e tyre, që fëmijët të mos përdoren si imazhe për përfitim elektoral.

Si rrjedhojë, Gjykata Supreme i ka vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet nga ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), se rregulloja e lartcekur, respektivisht neni 5 paragraf 3 i saj nuk sanksionon ç’do prani, paraqitje apo pjesëmarrje të të miturve në një aktivitet publik politik, por sanksionon angazhimin e tyre nga subjekti politik, kjo pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete politike dhe zgjedhore, duke garantuar respektimin e interesit më të mirë të fëmijës, si parim themelor i së drejtës ndërkombëtare dhe vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për më tepër kjo gjykatë vlerëson se interpretimi i dispozitës ligjore të lartcekur duhet të bëhet në përputhje me qëllimin e saj mbrojtës, andaj nocioni “angazhim” nuk mund të kufizohet vetëm në raste të pjesëmarrjes aktive në kuptimin e shpërndarjes së materialeve propaganduese, mbajtjes së fjalimeve apo ushtrimit të roleve formale në kuadër të fushatës, kjo pasi që në këtë rast vetë lejimi dhe mundësimi i pjesëmarrjes së të miturve në një aktivitet publik zgjedhor, të organizuar nga subjekti politik, përbën përfshirje në fushatë në kuptim të dispozitës së sipërcituar.

Në anën tjetër, kolegji i Gjykatës Supreme, ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se në këtë rast nuk është provuar angazhimi aktiv i të miturve dhe se ata kanë qenë të pranishëm në shoqërinë e familjarëve të tyre, mirëpo është vlerësuar se pavarësisht mos angazhimit të të miturve në këtë rast nuk mundë të përjashtohet përgjegjësia e subjektit organizator, (LVV). Si rrjedhojë, për zbatimin e dispozitës së lartcekur nuk është relevante nëse iniciativa për pjesëmarrje ka ardhur nga vetë të miturit apo nga prindërit e tyre, por në këtë rast është relevant fakti objektiv se subjekti politik ka organizuar aktivitetin dhe ka lejuar praninë



e tyre në një tubim elektorale, që tërthorazi nënkupton përgjegjësinë e subjektit politik ankues (në këtë rast organizator), pasi që i njëjti nuk ka respektuar rregullat zgjedhore që aktivitetet e tij të zhvillohen në përputhje me rregulloren e lartcekur. Për më tepër, referuar shkresave të lëndës rezulton e subjekti politik në fjalë, me rastin e ftesës për mbajtjen e tubimeve zgjedhore të përshkruara si më lartë, nuk ka provuar faktin se ka bërë thirrje që fëmijët e mitur të mos marrin pjesë në këto tubime zgjedhore, si dhe as me përgjigje në ankesë në PZAP, e as me ankesën e parashtruar në këtë gjykatë nuk ka dorëzuar ndonjë provë relevante që do të dëshmonte faktin se këta fëmijë të mitur kanë qenë nën shoqërimin e prindërve apo kanë pasur pëlqimin e tyre, apo eventualisht të njëjtit kanë qenë mbi moshën 15 vjeçare. Si rezultat i kësaj, edhe pretendimet ankimore për zbatimin e gabuar të drejtës materiale të nenit 5 paragraf 3 të Rregullores nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, kanë rezultuar të pabazuara. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se përfshirja e të miturve në aktivitete zgjedhore bie ndesh me qëllimin e qartë të rregullores, përkatësisht nenit 5 paragraf 3 të Rregullores nr. 07/2024, nga interpretimi i së cilës, rezulton se qëllimin e vetëm e ka parandalimin e instrumentalizimit të fëmijëve për qëllime politike apo elektorale. Si rrjedhojë, duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerësohet se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e duke u mbështetur në nenin 5 paragraf 3 të Rregullores nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, andaj pretendimet si në ankesë të ankuesit nga kjo gjykatë janë vlerësuar të paqëndrueshme.

Gjykata Supreme vlerëson se me rastin e shqiptimit të gjobës subjektit politik LVV, ankuesit në këtë rast, PZAP ka marrë në konsideratë natyrën dhe peshën e shkeljes, ndikimin e mundshëm të saj në procesin zgjedhor, si dhe faktin se subjekti politik ka qenë i njoftuar me obligimet ligjore gjatë fushatës dhe është dënua edhe më herët për shkelje të natyrës së njëjtë. Si rrjedhojë është vlerësuar se PZAP ka vepruar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, andaj edhe ankesa e ankuesit nga kjo gjykatë është vlerësuar e pabazuar.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.25/2026, datë 11.06.2026



8

Republika e Kosovës



Republika Ko

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik